

KALLËZUESI

Kallëzuesi është gjymtyra kryesore e fjalisë e shprehur me folje që hyn në marrëdhënie e lidhje kallëzuese me kryefjalën.

U përgjigjet pyetjeve: *ç'bën?, ç'bëri?, ç'ka bërë?, ç'do të bëjë?*

(1) Telefoni **ra** përsëri. Suzana e **kishte dëgjuar** me kryet ulur. Ai **buzëqeshi** hutueshëm.

Kallëzuesi është gjithnjë në lidhje me kryefjalën dha anasjelltas, ata nuk mund të kuptohen pa njëri-tjetrin. Kur një folje nuk hyn në lidhje me një kryefjalë, ajo nuk mund të jetë kallëzues, por vetëm gjymtyrë kryesore në një fjali njëkryegjymtyrëshe, duke qenë qendra organizuese e grupit foljor dhe e gjithë fjalisë.

Duke pasur parasysh se me se shprehet kallëzuesi, dallohen tre tipa:

- *kallëzuesi foljor;*
- *kallëzuesi emëror dhe*
- *kallëzuesi i shprehur me pjesë të pandryshueshme të ligjëratës.*

I. Kallëzuesi foljor është dy llojesh: i thjeshtë dhe i përbërë.

a) Kallëzuesi i thjeshtë foljor

Kallëzuesi i thjeshtë foljor shprehet me një formë foljore të çdo vete, kohe, mënyre e diateze, por edhe menjë formë foljore të përsëritur ose të shoqëruar me ndonjë pjesëz.

(2) Ushtari **ngriti** supet dhe **mënjanoi** kryet si fajtor. Unë **zgjata** dorën për t'u përshëndetur me të. Tjetri **shtangu** në vend. Sytë i **dhembnin** nga lodhja e tepërt.

❖ Kallëzuesi i shprehur me një nga mënyrat e foljes.

Kur themi se kallëzuesi shprehet me një nga mënyrat e foljes, do të thotë se shprehet me folje në mënyrën dëftore, lidhore, habitore, kushtore, dëshirore e urdhërore.

- Tipi më i zakonshëm është kallëzuesi që shprehet me folje në mënyrën dëftore. E hasim të shoqëruar shpesh edhe me pjesëza të ndryshme. Format e së tashmes dhe të së pakryerës mund të marrin përpara pjesëzën *po* për të shprehur një veprim të aktualizuar që është në zhvillim e sipër në çastin e ligjërimit ose në një çast të së shkuarës.

(3) Në këmbë të kodrave **shtrihen** fshatra të vogla. Treni **do të mbërrinte** një orë me vonesë. Demokratizimi i vendit **ka zgjuar** energji të pashtershme.

Ministrin **po e mbyste** shqetësimi. Ai **po përgjigjej** me përtesë.

- Kallëzues të shoqëruar me pjesëzat *sa, mend, desh, nuk, s', as që, s'para* dhe *dot*:

(4) Pemët **sa nuk thyheshin** nga pesha e borës. **Mend qau** kur e pa në atë ditë. Nga lodhja **deshu rrëzua** ne tokë. Kohën e fundit **s'para udhëtonte** shpesh. **As qëe përshkruante dot** bukurinë e asaj pikturë.

- Me folje në mënyrën lidhore zakonisht në fjalitë e përbëra, por edhe në fjali të thjeshta:
(5) *Të nesërmen u ngrit shpejt qetë mos vonohet. Kur të ketë martuar edhe më të voglin, do të vdesë më mendje të mbledhur. Të kenë ardhur, vallë? T'i kishte thënë një fjalë të paktën!*

- Me folje në mënyrën habitore përdoret kryesisht në fjali dëftore e pyetëse – thirrmore:
(6) *Po ja që zemra e një vajze nuk u pushtuaka me zor e me forcë. Ç'mëqenkej shëmtuar aq shumë me ato rroba!*

-Me folje në mënyrën kushtore :
(7) *Sikur të mos kishin ndërhyrë të tjerët, do të kishte shkuar keq puna. Po të këndonte ai, të gjithë do ta dëgjonin gojëhapur.*

- Me folje në mënyrën dëshirore:
(8) *Ju këndoftë zemra, se na kënaqët. Mallkimi më i rëndëritë mbi të ligjtëe përçarësit. Në pastë ardhur më parë, do të presë.*

- Me folje në mënyrën urdhërore:
(9) *Ik dhe ti bashkë me ta. Ju mos shkoni nga ajo rrugë se nuk ia dilni dot. Me format e urdhërores kallëzuesi del në stilin tregimtar dhe me një përdorim të veçantë: Rosaku ik, ai ndiq. Rosaku dil, ai qëllo.*

❖ **Kallëzuesi i thjeshtë foljor i formuar me kam+ paskajore dhe jam + përcjellore.**

Ndërtimet e tilla: **kam+ paskajore** kanë vlerën e së ardhmes dhe të së ardhmes së tëshkuarës dhe **jam + përcjellore** tëshmes dhe të së pakryerës të aktualizuar që shënon një veprim të zgjatur: *kam për të bërë = do të bëj, kasha për të bërë = do të bëja dhe jam duke bërë = po bëj, isha duke bërë = po bëja.*

(10) *Ne jemi duke e ngritur edhe më lart qytetërimin. Dielli ishte duke perënduar. Ai kishte për të ardhur, po nuk erdhi.*

❖ **Kallëzuesi i thjeshtë foljor mund të dalë edhe me forma më të ndërlikuara, që tregojnë kohëzgjatje, përforsim të veprimit ose nuanca të tjera:**

(11) *Mendimet e gjeneralit vërtiteshin e vërtiteshin në të njëjtën pikë. Vasha qau e qausa u tret. Urrejtja zien sa zienbrenda, pastaj shpërthen. Nuk desh që nuk desh ta linte vetëm. Këmbët iu morën. popër të rënë s'ra. Të ecur që ecën ky njeri!*

❖ **Kallëzues i shprehur me togfjalësha frazeologjike me vlerë foljore:**

(12) *Nuk po marr vesh ç'bëhet. (= nuk po kuptoj) Mullisi dha shpirt aty në mulli. (= vdiq) Fjala kishte marrë dhenë. (= ishte përhapur)*

❖ **Kallëzues i shprehur me forma të pashtjelluara foljore:**

Këto forma do të merren si kallëzues vetëm kur hyjnë në lidhje kalëzuesore me një emër a përemër në rasën emërore që funksionon si kryefjalë: **Me të lindurdielli**, karvani u nis për rrugë. **Babai u nispa dalëdielli**. Një përgjigje e tillë mjaftonte **për t'u provuar mendja e saj**.

b) Kallëzuesi i përbërë foljor

Kallëzuesi i përbërë foljor formohet nga dy fjalë kuptimplota, nga të cilat e para tregon **mënyrë veprimi** (fillim, vazhdim, rritje progresive të veprimit, mbarim) ose **modalitet** (domosdoshmëri, mundësi, supozim etj.), kurse e dyta shpreh një veprim. Kjo gjymtyrë e përbërë prej dy pjesësh, është formësuar si një tërësi e vetme nga ana e përmbajtjes dhe nga ana gramatikore. Të dyja pjesët që formojnë kallëzuesin e përbërë, shërbejnë si qendër ndërtimore e fjalisë.

Nisur nga struktura e tij, kallëzuesi i përbërështë disa llojesh:

❖ **Kallëzues i përbërëme folje aspektore + folje në lidhore, përcjellore, emër prejfoljor asnjans:**

-Fillimin e veprimit: *Vajza filloi (zuri, nisi) të këndonte me zë të lartë.*

- Vazhdimin e veprimit: *Vesa vazhdonte (vijonte) të pikonte nga pishat.*

-Rritjen progresive: *Uturima erdhi duke u shtuar. Temperaturat vinin duke u rritur. Përroi erdhi e fry si një kacek me ujë.*

- Mbarimin e veprimit: *Bari u tha e qyqja pushoi (mbaroi, reshti) së kënduari.*

❖ **Kallëzues i përbërëme folje modale + folje në lidhore ose formë e pashtjelluar foljore-pjesore:**

- Domosdoshmëri: *Këtë urdhër duhej ta zbatonte. Nderi do shpërblyer me nder.*

- Mundësi: *Ato shenja mund të merreshin fare mirë si provë e përgjithshme.*

❖ **Kallëzues i përbërëme dy folje në mënyrën dëftore (të lidhura me lidhëz ose jo):**

- Ai, sa herë takon të mbesen, **fillon e harrohet** pas lojës me të.

Në këtë grup përfshihen edhe forma kallëzuesish që shprehin një veprim të zgjatur në rritje progresive e që janë forma sinonimike me kallëzuesin që ka si pjesë të parë një folje aspektore dhe si pjesë të dytë një folje në lidhore ose një përcjellore, të cilin e trajtuam më lart: (1) *Djemtë e fshatit zunë e pakësoheshin nga dita në ditë.* (2) *Përroi erdhi e fry si një kacek me ujë.* (3) *Shërbëtori zuri po i tregonte shkakun e vonesës. (nis, zë + pa lidhëz + folje në dëftore).*

II. Kallëzuesi emëror formohet prej dy pjesësh: prej foljes këpujë **jam** dhe prej gjymtyrës emërore. Quhet këpujë (nga lat. *copula* = lidhëz, që lidh), sepse vë në lidhje kryefjalën me pjesën emërore, p.sh.: *Kjo vajzë është e bukur dhe e mençur.*

Gjymtyra emërore e kallëzuesit emëror shprehet:

a) me emër (në rasën emërore, gjinore, emër me ose pa parafjalë): (1) *Gjergj Fishta është shkrimtar i madh.* (2) *Këto mollëjanë të Korçës.* (3) *Dita e nesërme do të jetë me shi.* (4) *Vitrina do të ishte prej druri vendor.*

b) me mbiemër: (1) *Besimi ishte i dashuruar.* (2) *Ajo ishte e tronditur.*

c) me përemër: (1) *Kush je ti, more djalë?* (2) *Ja, kjo ishte gjithçka.* (3) *Ti s'je ai që kujtojnë të tjerët.*

ç) me numëror: *Ora është shtatë.*

d) me paskajore: (1) *Ajo vilë ishte për të pushuar gjatë verës.* (2) *Këto syze janë për të parë afër.*

dh) me ndajfolje: *Kohët e fundit ai ishte më mirë.*

e) me togfjalësh: (1) *Kjo ishte një lloj parandjenje ndarjeje.* (2) *Rruga ishte tërë baltë.*

Këpuja mund të marrë edhe foljet modale *duhetdhe mund*, si dhe folje aspektore: (1) *Ti duhet të jesh e fortë.* (2) *Studentët mund të ishin me prindërit.* (3) *Rreziku i gripit të shpendëve do të vazhdojë të jetë i pranishëm edhe gjatë këtij viti.*

Mbani mend:Kur folja **jam** ndiqet nga **një pjesore**, atëherë ajo nuk kryen funksionin e një kallëzuesi emëror, por është një kallëzues i thjeshtë foljor: (1) *Ata janë shqetësuar për rezultatet e provimit.* (kallëzues i thjeshtë foljor)

III. Kallëzuesi i shprehur me pjesë të pandryshueshme të ligjëratës

Në funksion të kallëzuesit mund të dalin edhe disa **pjesëza, pasthirrma dhe onomatope**, që japin idenë e një veprimi që bën kryefjala. Pjesëzat *po, jo*, vetëm ose të përsëritura me lidhëzat *e, që, se: po që po, po se po, jo që jo, po e po etj.*, zëvendësojnë një folje që është përmendur ose që thuhet më pas. Kur përsëriten ato japin idenë e një veprimi të përforcuar.

(1) *Ajo ka frikë nga gjarpërinjtë, ti jo.* (2) *Unëjo qëjo, po edhe shefi nuk kishte ftesë.* (pjesëza)

(3) *Lumja ajo për fëmijët që rriti.* (pasthirrmë) (4) *Sa hyri në dush, cërrr telefoni.* (5) *Sapo u takua me Shpresën, ajo pllaq-plluq në të dyja faqet.* (6) *Rrotullohej rreth tavolinës dhe trak me gërshërë.* (onomatope- tingullimitime)